



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 2264/ prot.
12

Tiranë, më 24.07.2025

V E N D I M

Nr. 41 datë. 24.07.2025

**“PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. GERTI TARTALE NË VENDIN
VAKANT PËR INSPEKTOR JOMAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I
LARTË I DREJTËSISË MË DATË 27.05.2024”**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Znj. Elena Pelushi - Kryetar
Znj. Lindita Ziguri - Anëtar
Znj. Joana Sorraj - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Amanta Jasa
Znj. Zonje Shelqizi

Në mbledhjen e datës 23.07.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit për inspektor jomagjistrat: Z. Gerti Tartale

OBJEKTI: Urdhërimi i ndalimit të z. Gerti Tartale, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024.

Komiteti pasi u njoh me aktet si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 27.05.2024, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 4 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 74 datë 26.06.2024 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 26.06.2024, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 02.07.2024, ku vendosi për shqyrtimin e dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor Jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistrat për pozicionin e inspektorit".
4. Z. Gerti Tartale, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin nëpërmjet kërkesës me nr. 1747 prot., datë 24.06.2024 për vendin vakant të Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës bazuar në detyrimet ligjore, të përcaktuara nga neni 209, neni 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", si dhe urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit,

pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë". Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 05.07.2024, kandidati z. Gerti Tartale, është paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.
6. Në datën 09.07.2024 kandidati z. Gerti Tartale ka depozituar tek sekretariati teknik, formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit A, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", me shkresën përcjellëse me nr. 2230 prot. datë 03.08.2024, i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), listën e kandidatëve dhe të personave të lidhur me ta, sikurse janë deklaruar prej vetë kandidatëve, që i nënshtrohen procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, si edhe kopjet e deklaratave të nënshkruara nga secili prej tyre.
8. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar.
9. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati z. Gerti Tartale, ku deklarohet se, është pajisur me kredencialet dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
10. Kandidati z. Gerti Tartale e ka përmbushur detyrimin për të plotësuar në sistemin EACID dhe dorëzuar si elektronikisht dhe fizikisht të plotësuar pranë ILDKPKI-së Deklaratën e

Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

11. ILDKPKI, në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", me aktin nr. 193/23 prot., datë 13.12.2024, ka dërguar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin z. Gerti Tartale dhe personat e lidhur me të.
12. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, si dhe në zbatim të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", ky institucion kryen verifikime pranë subjekteve publike dhe private që lejon ligji, të të dhënave mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit z. Gerti Tartale dhe personave të lidhur me të si dhe administron/analizon të dhënat që dalin nga procesi i verifikimit të kriterit të pasurisë.
13. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit z. Gerti Tartale, referuar aktit të përfundimit të kontrollit të deklaratës së pasurisë rezulton se ILDKPKI me shkresën nr. 193 prot., datë 06.08.2024, i është drejtuar me kërkesa për informacion lidhur me kandidatin z. Gerti Tartale institucioneve bankare: *Banka e Shqipërisë, Banka Raiffeisen sha, Banka Kombëtare Tregtare sha, Banka Intesa Sanpaolo sha, Banka Tirana sha, Banka e Bashkuar e Shqipërisë sha, Banka ProCredit sha, Banka e Parë e Investimeve sha, Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka Credins sha, Banka Union sha, Banka OTP Albania sha, Raiffeisen Leasing sha, Porsche Leasing sha, RFZ Invest sha, Credins Invest sha, DPSHTRR, Qendra Kombëtare e Biznesit, DPT, ISSH, D.P Detare, ASHK online.*
14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germa "a" dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si edhe në zbatim të seksionit C, të Kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit", kandidati z. Gerti Tartale ka depozituar dokumente.
15. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit z. Gerti Tartale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Shërbimit Informativ të Shtetit, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore pranë Ministrisë së Brendshme.

16. Në mbështetje të nenit 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, me shkresën me nr. 2234 prot., datë 03.08.2024, është kërkuar informacion që lidhet me integritetin e secilit prej kandidatëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke verifikuar mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të Kreut III dhe në zbatim të pikës 2, germa "b" Kreu V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Gjithashtu, në zbatim të kushtit të përcaktuar në pikën 6, germa "d" të nenit 209 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, për verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit z. Tartale, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me shkresën nr. 2235 prot., datë 03.08.2024, Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.
17. Për verifikime të mëtejshme kriterëve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe në pikat 59 dhe 60 të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit" Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë formularin e vetëdeklarimit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të plotësuar nga kandidati jomagjistrat, në Prokurorinë e Përgjithshme, në përgjigje të të cilës kanë ardhur shkresat përkatëse.
18. Në funksion të verifikimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 209, pika 6, germave "b" dhe "d", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i lartë i Drejtësisë, i është drejtuar me kërkesë për informacion lidhur me çështje gjyqësore apo çështje penale në ngarkim të kandidatëve, gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhe prokurorive pranë tyre Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Prokurorisë së Posaçme, të cilat kanë kthyer përgjigjet përkatëse, sipas shkresave të gjykatave nr. 1013/1, datë 18.06.2025; nr. 1337/1, datë 17.06.2025; nr. 620/1, datë 17.06.2025; nr. 3187/1 datë 18.06.2025; nr. 1167/1, datë 18.06.2025; nr. 618/1, datë 20.06.2025; nr. 2663/1, datë 19.06.2025; nr. 3219/1, datë 23.06.2025; nr. 6061/1, datë 23.06.2025; nr. 1179/1, datë 23.06.2025; nr. 3572/3, datë 04.07.2025; nr. 2439/1, datë 27.06.2025, nr. 1869/13 prot., datë 10.07.2025 (përcjellë me email) nr. 1869/14 prot., datë 14.07.2025 dhe të prokurorive nr. 6213/1, datë 16.06.2025; nr. 2485/1, datë 18.06.2025; nr. 1768/1 datë 17.06.2025; nr. 3601/1, datë 18.06.2025; nr. 10341/1, datë 18.06.2025; nr. 1570, datë 17.06.2025; nr. 5379/1, datë 18.06.2025; nr. 5027/1, datë 19.06.2025; nr. 7622/1, datë 19.06.2025; nr. 8601/1, datë 19.06.2025; nr. 16562/1 datë 30.06.2025; nr. 22680, datë 01.07.2025; nr. 1868/13 prot., datë 10.07.2025.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, që kanë të bëjnë me përvojën profesionale si "Jurist", jo më pak se pesëmbëdhjetë vite punë në çastin e kandidimit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "c", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar me kërkesë për informacion Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror me shkresën nr. 2232 prot, datë 03.08.2024, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës me shkresën 2834, datë 22.10.2024, në lidhje me periudhën e derdhjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 8503/1 prot, datë 09.08.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror ka kthyer përgjigje me shkresat nr. 8294/1 prot, datë 20.08.2024 dhe nr. 8449/1 prot, datë 23.08.2024, si dhe Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 18473/1 prot, datë 29.10.2024.

Me shkresat nr. 2213, datë 03.08.2024, nr. 2213/1 prot datë 03.08.2024 nr. 2213/2, datë 03.08.2024 dhe nr. 2213/7, datë 08.10.2024 nga ana e ILD-së është kërkuar informacion përkatësisht nga Albanian University, Ministria e Mbrojtjes, Banka Kombëtare Tregtare, duke kërkuar përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, kontratë individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat ose përshkrim pune, gjatë kohës së punësimit si lidhur me pozicionet e punës dhe janë kthyer përgjigje duke përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 2213/3, datë 03.08.2024, të ILD i është kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë për përshkrimin e hollësishëm të llojit të punës, me kontrate individuale nëse ka, rregullore, akte që kanë të përcaktuar detyrat ose përshkrim pune, gjatë kohës së punësimit lidhur me pozicionin e punës si "Specialist në Sektorin e Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) në Ministrinë e Drejtësisë", për periudhën shkurt 2018-nëntor 2021. SHKBB me shkresën nr. 1309/1, datë 29.08.2024, regjistruar në ILD me nr. 2213/5, datë 02.09.2024, ka informuar se në dosje nuk ka kontratë pune, sa i takon përshkrimin të pozicionit të punës dhe nuk mund të vihet në dispozicion sepse përbën sekret.

Në vazhdim, mbi bazën e një kërkesë tjetër të ILD, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve me shkresën nr. 602/1, datë 25.06.2025 të regjistruar në ILD me nr.1871/1 prot., datë 26.06.2025, ka përcjellë informacionin se:

".... shtetasi Gerti Tartale ka qenë i punësuar në SHKBB gjatë periudhës 09.02.2021 deri në datën 03.11.2021, me detyrën konkretisht:

1. Me Urdhër nr. 1385/1, datë 09.02.2018 "Për emërim në detyrë" të Ministrit të Drejtësisë, në detyrën e specialistit në sektorin e Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës pranë Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve.

2. Me urdhër nr. 444, datë 29.07.2021 "Për lirim dhe emërim në detyrë" të Ministrit të Drejtësisë, në detyrën e inspektorit në sektorin e Drejtimit dhe Analizës në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, pranë institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogzhinë dhe Kavajë.

Theksojmë se, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në sistemin e Burgjeve në organikat e tij të kësaj periudhe, konkretisht:

1. Me Urdhër nr. 58, datë 24.04.2017 të Kryeministrit "Për miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Sistemit të Institucioneve në Varësi të saj";

2. Me Urdhër nr. 43, datë 25.03.2021 të Kryeministrit "Për miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Sistemit të Institucioneve në Varësi të saj".

nuk ka të parashikuar pozicionin e punës "Jurist", për rrjedhojë z. Gerti Tartale nuk ka ushtruar detyrën "Jurist".

Në lidhje me detyrën e tij funksionale:

1- Bazuar në "Rregulloren e Organizimit, Funksionimit, dhe veprimtarinë Informative të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve", miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 4554/2, datë 16.08.2017, Z. Gerti Tartale ka ushtruar detyrën e tij funksionale të Specialistit të Sektorit të Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës dhe të inspektorit të Sektorit të Drejtimit dhe Analizës, pranë IEVP Rrogozhinë dhe Kavajë sipas përshkrimeve përkatëse të punës në këtë rregullore (e cila është klasifikuar "Sekret").

Gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën në SHKBB, z.Gerti Tartale ka patur atributet e oficerit të policisë gjyqësore, bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 9397, datë 12.05.2005 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve".

Bashkëlidhur kësaj shkrese Ju përcjellim fotokopje të: Urdhër nr. 1385/1, datë 09.02.2018, Urdhër nr. 444, datë 29.07.2021, Urdhër nr. 58 datë 24.04.2017, Urdhër nr. 43, datë 25.03.2021."

Kjo përgjigje së bashku me dokumentacionin shoqëruar i është vënë në dijeni kandidatit z. Gerti Tartale, i cili ka sjellë shpjegime dhe dokumentacion, të administruar në ILD me nr. 1917/2 prot., datë 14.07.2025 dhe me nr. 2243 prot., datë 23.07.2025. Në shpjegimet e datës 14.07.2025, kandidati ndër të tjera është shprehur se: "Në lidhje me ushtrimin e funksionit të specialistit, me formim juridik (pra timin), në fushën e detyrave të Sektorit të Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, ka qenë dhe kontrolli i zbatueshmërisë, së akteve ligjore dhe nënligjore, i kryerjes së aktiviteteve të përditshme, si nga administrata e I.E.V.P., si nga punonjësit me uniformë, ashtu edhe nga administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga punonjësit me uniformë. Përshkrim pune, në të kundërt, të citimit të Shkresës Nr. 602/1, Dt.25.06.2025, të SH.K.B.B., në kohën, kur unë kam punuar në atë institucion shtetëror, nuk ka pasur, ashtu siç nuk kanë pasur, edhe institucione të tjera shtetërore, si Avokatura e Shtetit, etj., në periudhën që unë kam punuar atje 2014-2017. Në SH.K.B.B., ka pasur vetëm "Rregullore të Organizimit, Funksionimit dhe Veprimtarinë Informative të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve". Në lidhje me citimin në Fq.2, të shkresës Nr. 602/1, Dt.25.06.2025, të SH.K.B.B., se: "... z. Gerti Tartale ka ushtruar detyrën e tij funksionale të specialistit të Sektorit të Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës dhe të inspektorit të Sektorit të Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës, pranë IEVP Rrogozhinë dhe Kavajë sipas përshkrimeve përkatëse të punës...", është pjesërisht i vërtetë. Ky citim është i vërtetë, përse i përket faktit, se unë kam punuar fizikisht, vetëm në Sektorin e Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, në Drejtorinë Qendrore, të këtij shërbimi dhe nuk kam punuar fizikisht, asnjë ditë të vetme, në asnjë I.E.V.P. dhe nuk ekziston asnjë shkresë e vetme, që unë të kem bërë dhe të vërtetoj, që kam punuar ndonjëherë, as fizikisht

dhe as për llogari, të ndonjë I.E.V.P. Në lidhje me citimin, po në Fq.2, të Shkresës Nr.602/1, Dt.25.06.2025, të SH.K.B.B., se gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën në SH.K.B.B., z. Gerti Tartale ka patur atributet e oficerit të policisë gjyqësore”, nuk do të thotë që të drejtat e njohura nga një ligj organik, ushtrohen detyrimisht, nga të gjithë punonjësit e një institucioni, vetëm se janë parashikuar në ligj. Citimi im se, nuk kam punuar fizikisht, asnjë ditë të vetme, në asnjë I.E.V.P., vërtetohet, nga shkresat si më poshtë, po citoj, shkresa dhe fakte, të cilat, as nuk janë përmendur, në Shkresën Nr. 602/1, Dt.25.06.2025, të SH.K.B.B. dhe për më tepër, as nuk janë bashkëngjitur: ...”. Dhe në shpjegimet e datës 23.07.2025, ndër të tjera lidhur me pozicionin e punës në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, shprehet se: “Në lidhje me ushtrimin e funksionit të specialistit, me formim juridik pra timin, në fushën e detyrave të Sektorit të Drejtimit të Përgjithshëm dhe Analizës në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, të Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë dhe kontrolli i zbatueshmërisë, së akteve ligjore dhe nënligjore, i kryerjes së aktiviteteve të përditshme, si nga administrata e I.E.V.P., si nga punonjësit me uniformë, ashtu edhe nga administrata e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga punonjësit me uniformë. Përshkrim pune, në të kundërt, të citimit të Shkresës Nr. 602/1, Dt. 25.06.2025, të SH.K.B.B., në kohën, kur unë kam punuar në atë institucion shtetëror, nuk ka pasur, ashtu siç nuk kanë pasur, edhe institucione të tjera shtetërore, si Avokatura e Shtetit, etj., në periudhën që kam punuar atje 2014-2017. Në SH.K.B.B., ka pasur vetëm “Rregullore të Organizimit, Funksionimit dhe Veprimtarinë Informative të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve”. Kontrolli i zbatueshmërisë, së akteve ligjore dhe nënligjore, normalisht që nuk mund të bëhej, përveç, nga një punonjës, me formim juridik. Sqarime dhe dokumenta të tjera, nuk disponoj, sepse gjithçka kam pasur në disponim tim, jua kam dërguar, si me postë fizike, me kthim konfirmimi, si të skanuara me e-mail.”

20. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, u vlerësua t’i drejtohem i me kërkesë për informacion Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë me nr. 2238 prot., datë 03.08.2024. Kërkesa është bërë në mbështetje të nenit 209, pika 6, germa "ç", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe seksionit C të kreut IV, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", duke kërkuar nëse kandidati, në mënyre aktive, ka ushtruar profesionin e avokatit të paktën në dy vitet e fundit. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë është përgjigjur me shkresën nr. 350 prot., datë 04.09.2024, informacion i cili është administruar në dosjen e kandidatit.
21. Lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 209, pika 6, germa “d” të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është dërguar shkresa nr. 2235, datë 03.08.2024 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku është kërkuar informacion nëse kandidati është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 13027/1 prot., datë 08.08.2024.

22. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 209, pika 6, germa "e", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe pikës 62, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit nëse secili kandidat, përfshihet në rastin e posaçëm të nenit 209, pika 6, germa "e", e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar: "e) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 2 korrikut 1991" apo në njërin nga rastet e pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë". Me shkresën nr. 2231 prot, datë 03.08.2024, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati i sipërcituar, për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Në vijim të procedurave të verifikimit që lidhet me integritetin e kandidatëve për inspektor jomagjistratë si dhe për të shmangur çdo lloj konflikti interesi që bie ndesh me nenin 209, pika 6, gjerat "dh", "ë" dhe "f" të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar është njoftuar zyrtarisht secili kandidat që të plotësojë formularët përkatës që lidhen me:

- mospasjen e funksioneve politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit;
- mosqenien bashkëpunëtorë, informatorë ose agentë të ndonjë shërbimi sekret;
- mosqenien anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë grupi interesi, të tilla si shoqata ose sindikata etj., në kohën e kandidimit.

Për sa i takon kandidatin z. Gerti Tartale, është paraqitur në ambientet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka dorëzuar të plotësuar secilin prej formularëve të mësipërm.

24. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 27 e vijues të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm.

25. Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të pjesës C, të Kreut IV vendimit nr.

536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë, për pozicionin e inspektorit", Urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Kryetari i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 23.07.2025, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë çështja me objekt shqyrtimin e aplikimit të kandidimit të z. Gerti Tartale, për vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

II. Vlerësimi i Komitetit

26. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë nga aktet që përmban dosja e kandidimit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Gerti Tartale për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
27. Në nenin 209, pika 6, germa "c" e ligjit nr. 115/2016, parashikohet si kusht që kandidati duhet të ketë përvojë pune si jurist, të paktën 15 vjet. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, gjatë procesit të verifikimit rezulton se kandidati ka dorëzuar librezhën e punës, vërtetim nr. 746, datë 06.06.2024, nga shqyrtimi i të cilit rezultojnë këto periudha punësimi:
- Pedagog, Shkolla e Lartë Jo- Publike "UFO" për periudhën 01 nëntor 2006-01 gusht 2007;
 - Specialist, Drejtoria e Harmonizimit të Legjislacionit, Ministria e Mbrojtjes për periudhën 01 shtator 2007- 16 janar 2008;
 - Jurist, Departamenti i Çështjeve Ligjore, BKT Drejtoria e Përgjithshme, për periudhën 16 janar 2008- 30 nëntor 2010;
 - Senior Jurist, Departamenti i Çështjeve Ligjore, BKT Drejtoria e Përgjithshme për periudhën 01 dhjetor 2010- 16 maj 2011;
 - Person fizik, DRSSH Tiranë për periudhën 10 prill 2011-30 qershor 2013;
 - Avokat Shteti, Avokatura e Shtetit për periudhën 19 shkurt 2014- 25 janar 2018;
 - Specialist në Sektorin e D.P.A, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë, për periudhën 09 shkurt 2018- 03 nëntor 2021;
 - Jurist, Eurosig sh.a për periudhën 12 nëntor 2021-28 prill 2022;
 - Jurist pranë Departamentit Ligjor, INSIG sh.a për periudhën 28 prill 2022 deri në momentin e aplikimit.
28. Nga të dhënat sa më sipër, konstatohet se për periudhën e punës prej 3 vite, 8 muaj e 25 ditë, të kryer pranë Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, referuar përgjigjes së kësaj të fundit me nr. 602/1 prot., datë 25.06.2025, nuk provohet që

kandidati z. Gerti Tartale të ketë përvojën e “juristit”. Edhe nga shpjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga kandidati z. Gerti Tartale, lidhur me këtë periudhë pune, nuk u evidentuan të dhëna të reja në këtë drejtim. Në këto kushte, duke zbritur këtë periudhë, kandidati z. Gerti Tartale rezulton të ketë në momentin e aplikimit një përvojë pune prej 13 vite, 4 muaj dhe 22 ditë dhe si e tillë, nën 15 vite që kërkon neni 209, pika 6, germa “c” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar. Për rrjedhojë kandidati nuk plotëson kushtin ligjor lidhur me përvojën e punës si “Jurist”.

29. Komiteti vlerëson të ritheksojë se kushtet e kandidimit për Inspektor Jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për t’u vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Komiteti. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.
30. Për këto arsye, në zbatim të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr.115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti vjen në përfundimin se kandidati Gerti Tartale është në kushtet e ndalimit për shkak të mosplotësimit të kushtit ligjor të parashikuar nga neni 209, pika 6, germa “c” të ligjit nr. 115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.
31. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet me sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për inspektor jomagjistrat, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit Gerti Tartale, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 27.05.2024, pasi kandidati nuk plotëson kushtin ligjor të parashikuar në nenin 209, pika 6 germa “c” e ligjit nr. 115/2016 " Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të ndryshuar, pikave 27 “b”, 28 “a” dhe “b”, 30, 31,

72, 73, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

V E N D O S I:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Gerti Tartale, në vendin vakant për inspektor jomagjistrat, i shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datë 27.05.2024.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit z. Gerti Tartale.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR

Lindita Ziguri



KRYETAR

Elena Pelushi



ANËTAR

Joana Sorraj

